



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë
Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

Data - Datum	11.04.2019
Referencë/a	08 nr. 12-1/2019
Për/Za/To :	Samedin Hashim Dina nga Rahoveci
Zona Kadastrale:	Rahovec
Përmes/ Prekp/Through:	Afrim Oruqi - Drejtor Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi, dhe Pronë
Nga/Od/From/	Spektori për pronë
Subjekt/Subekat/Subject:	Konkluzion

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Spektori për pronë e K.K. Rahovecit, në bazë të nenit 10 të Ligjit mbi shqyrtimin e marrëdhënieve pasurore të krijuara me uzurpimin arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore, “Gazeta zyrtare e KSAK”, nr. 46/77 dhe nenit 153, të Ligjit mbi procedurën administrative nr. 05/L-031, merr:

K O N K L U Z Ë

M B I L E J I M I N E E K Z E K U T I M I T

- I. VËRTETOHET SE** Vendimi i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – spektori për pronë i K.K. Rahovecit, 08 nr. 12/2019 të datës 11.03.2019, është bërë i plotfuqishëm më datë 03.04.2019 dhe **LEJOHET** ekzekutimi i tijë me shpenzimet e uzurpuesit arbitrar Samedin Hashim Dina nga Rahoveci.
- II.** Afati i fundit për të mënjauar murin rrethues, është më datë **22.04.2019**. Nëse deri me këtë datë i përmenduri vullnetarisht nuk mënjanon objektin dhe pjesën e ngastrës së uzurpuar nr. **1423-0** të bie në gjendje të mëparshme, **ekzekutimi do të kryhet me dhunë**.

- III. Mbi shpenzimet e procedurës së ekzekutimit do të vendoset me konkluzë të veçant.
- IV. Ankesa nuk e ndalon fillimin e ekzekutimit.

ARSYETIM

Me vendimin e Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e K.K. Rahovecit, 08 nr. 12/2019 të datës 11.03.2019, është vërtetuar se Samedin Hashim Dina nga Rahoveci, me ndërtimin e murit rrethues, në gjatësi prej 20 m², pa dëshmuar leje ndërtimi nga organi komunal, ka uzurpuar pjesën e parcelës nr. 1423-0 në emër të P.sh. e Kosov. K.K. Rahovec – Rrugë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.00,02 m² më afër të pasqyruar në kopjen e panit, të hartuar nga eksperti teknik – gjeometër.

Sipas dispozitivit (nenit II.) të vendimit në fjalë, uzurpuesi arbitrar Samedin Hashim Dina nga Rahoveci, ka qenë i obliguar që në afat prej 15 ditësh, nga dita e publikimit deri te dita e plotëfuqishmërisë së vendimit, ta lirojë pjesën e ngastrës së uzurpuar dhe të njëjtën të bie në gjendje të mëparshme.

Pasi që i përmenduri nuk ka vepruar sipas vendimit të cekur më lartë, kjo drejtori, sipas detyrës zyrtare, është e obliguar që ekzekutimin ta kryej në mënyrë të dhunshme me shpenzimet e uzurpuesit.

Nga arsyet të cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të konkluzës.

U vendos pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë – Sektori për pronë në K.K. Rahovecit më 16.10.2017.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër kësaj konkluze është e lejuar ankesa e posaçme në Agjencinë kadastrale të Kosovës në Prishtinë në afat prej 8(tetë) ditësh, nga dita e pranimiit nëpërmjet kësaj drejtorie.

HARTUESI

Jur. i. Diplumar. Nazmi Krasniqi



DRJETORI

Afrim Oruqi

